



# EDUKIMI MJEDISOR



# *Qershor 2025*

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

" Bota natyrore është pasuria më e çmuar që kemi. Ne jemi plotësisht të varur prej saj – dhe duhet ta mbrojmë."

David Attenborough

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujorë Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit mars 2024. Aktivitete janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **307**

Specialistë të angazhuar **22**

Orë mjedisore të realizuara **20**

**20** Shkolla të përfshira

**21** Mësues të përfshirë



# “EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



## 10 qershor 2025, Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, nën moton “Mbroni mjedisin tuaj për një botë më të gjelbër dhe të shëndetshme”, specialistët e AdZM Shkodër organizuan një aktivitet sensibilizues në shkollën 9-vjeçare “Prekë Gjoni”. Gjatë orës së hapur mjedisore, të zhvilluar në ambientet e jashtme të shkollës, nxënësit morën pjesë në mbjellje bimësh, si dhe në kujdesin ndaj kopështit botanik, duke dhënë mesazhe për mbrojtjen dhe gjelbërimin e mjedisit.

## 15 qershor 2025, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Prekë Gjoni”, në bashkëpunim me specialistët e AdZM Shkodër, krijuan një kënd të gjelbër në ambientet e shkollës, duke zgjedhur me kujdes bimët dhe duke ndarë informacion mbi rëndësinë dhe veçoritë e tyre.

ditë botërore

edukim mjedisor

biodiversitet



# “EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



## 3 qershor 2025 Dita Botërore

Në shkollën 9-vjeçare "Irfan Hjarullai", në kuadër të Ditës Botërore të Biçikletës u zhvillua një orë mjedisore nga ADZM Dibër. Nxënësit interpretuan pjesën teatrale "Biçikleta që shpëtoi planetin", duke theksuar përfitimet e biçikletës për shëndetin dhe mjedisin. Aktiviteti kishte për qëllim të forcojë edukimin mjedisor dhe të nxisë përdorimin e biçikletës në jetën e përditshme.

## 4 qershor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një aktivitet ndërveprues në shkollën "Myslim Shehu", ku nxënësit u angazhuan në lojën edukative "Misioni Mjedor". Përmes një lojërave fëmijët u njohën me veprime konkrete për mbrojtjen e mjedisit, si riciklimi, mbjellja e pemëve dhe kursimi i burimeve natyrore. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin për çështjet mjedisore në mënyrë argëtuese dhe të kuptueshme për moshat e reja.

## 11 qershor 2025, Dita Botërore e Rrëqebullit të Ballkanit

Në kuadër të edukimit mjedisor, ADZM Dibër organizoi një orë ndërgjegjëse në shkollën 9-vjeçare "Papa Gjon Pali II", me fokus tek rrëqebulli i Ballkanit – një nga speciet më të rralla dhe të mbrojtura në rajon. Nxënësit u informuan mbi sjelljen, habitatin dhe rëndësinë ekologjike të këtij gjatari, si dhe mbi kërcënimet që e rrezikojnë, përfshirë humbjen e habitatit dhe gjuetinë e paligjshme.



ditë botërore

ekosistem

Rrëqebulli i Ballkanit

shëndeti mjedisor



## 11 qershor 2025, Dita Botërore e Rrëqebullit të Ballkanit

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Rrëqebullit të Ballkanit, specialistët e ADZM Lezhë zhvilluan një aktivitet informues me nxënësit e klasës së katërt të shkollës 9-vjeçare “Fran Ivanaj”. Gjatë aktivitetit, fëmijëve iu prezantuan materiale informuese dhe ilustruese mbi rrëqebullin e Ballkanit, duke përfshirë karakteristikat fizike, zonat e shpërndarjes, rolin ekologjik si dhe kërcënimet që e rrezikojnë, si humbja e habitatit dhe gjuetia e paligjshme.







## 4 qershor 2025, Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, specialistët e ADZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasave 6-7 në shkollën “Selman Ali Xaka”, ku ata krijuan postera me mesazhe ndërgjegjësuese për mbrojtjen e mjedisit dhe më pas diskutuan mbi rëndësinë e veprimeve të vogla për kujdesin ndaj natyrës.

## 16 qershor 2025, Dita Botërore e Breshkave Ujore

Në kuadër të Ditës Botërore të Breshkave Ujore, fëmijët e kopshtit “Varosh” në Krujë morën pjesë në një aktivitet edukues dhe argëtues të organizuar nga specialistët e AdZM Durrës. Ata u njohën me rëndësinë e breshkave të ujit në natyrë dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre. Me materiale të riciklueshme, fëmijët krijuan dhe ngjyrosën modele breshkash, duke nxitur kreativitetin dhe ndërgjegjësimin mjedisor përmes lojës



# “EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



## 10 qershor 2025, Vizitë në Muzeun e Shkencave të Natyrës

Specialistët e AdZM Tiranë organizuan një vizitë në Muzeun e Shkencave të Natyrës, me nxënësit e klasës së pestë ë shkollës 9-vjeçare “Hasan Tahsin”. Ata patën mundësinë të njihen nga afër me larinë e faunës tokësore dhe ujore. Ekspertët ofruan informacione dhe fakte të rëndësishme, duke i ndihmuar nxënësit të pasurojnë njohuritë e tyre mbi biodiversitetin dhe natyrën.

## 11 qershor 2025, orë mjedisore

Specialistët e ADZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore krijuese me nxënësit e klasës së 6-të në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”. Gjatë aktivitetit, fëmijët përdorën materiale të riciklueshme për të krijuar stacione ushqimi për shpendët harabelor, të cilat më pas i vendosën në degët e pemëve. Ky aktivitet nxiti ndjeshmërinë dhe dashurinë për natyrën, duke përçar mesazhin për rëndësinë e ndihmës ndaj zogjve në mjedisin natyror.

## 13 qershor 2025, orë mjedisore

Nxënësit e klasave të gjashta të shkollës “Vatra e Dijes” morën pjesë në një vizitë të organizuar në Parkun Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe në Qendrën e Vizitorëve. Gjatë kësaj vizite, ata njohën nga afër florën dhe faunën e pasur të parkut, duke mësuar për rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit dhe mbrojtjes së natyrës. Vizita u zhvillua nën drejtimin e specialistëve të ADZM Tiranë, të cilët ndihmuar në thellimin e njohurive dhe ndërgjegjësimin e nxënësve.

vizitë edukuese

krijimtari

ditë botërore

Parku Kombëtar "Mali i Dajtit"



## 11 qershor 2025 Dita Botërore e Rrëqebullit

Në kuadër të Ditës Botërore të Rrëqebullit specialistët e ADZM Elbasan organizuan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës 9-vjeçare “Ibrahim Alliu”. Në këtë aktivitet u theksua se rrëqebulli nuk është vetëm një specie e rrallë dhe e mrekullueshme, por edhe simbol i pyjeve dhe i ekosistemeve të shëndetshme në natyrën tonë.





# “EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



## 5 qershor 2025, Dita Botërore e Mjedisit

Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, AdZM Fier, me mbështetjen e Qendrës Rinore “Epoka e Re”, Bashkisë Divjakë dhe Prefekturës Fier, organizuan një aksion pastrimi të vijës bregdetare të plazhit të Divjakës. Ky aksion kontribuon në përgatitjen e sezonit turistik veror 2025, duke siguruar një ambient më të pastër dhe më të shëndetshëm për pushuesit dhe vizitorët.

## 15 qershor 2025, Dita Botërore e Erës

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Sulzotaj” morën pjesë në një aktivitet edukativ në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, ku u njohën me vlerat natyrore të parkut dhe vëzhguan shpendët në zonat ujore. Ky aktivitet i sensibilizoi ata për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe ruajtjes së biodiversitetit.

## 21 qershor 2025, aksion pastrami

Stafi i ADZM Fier, së bashku me grupin “Korpusi i Vullnetarëve”, organizoi një aksion pastrimi për të kontribuar në ruajtjen e mjedisit dhe përmirësimin e ambientit lokal. Ky bashkëpunim nxiti ndërgjegjësimin dhe angazhimin qytetar për një mjedis më të pastër.

## 24 qershor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Fier zhvilluan një sesion informues me studentët e Fakultetit të Shkencave të Pyjeve në Tiranë, si dhe me studentë nga Fakulteti i Pyjeve në Rumani. Gjatë aktivitetit, u realizua edhe një vizitë në terren, e cila shërbeu për të njohur nga afër vlerat e parkut, biodiversitetin dhe masat e mbrojtjes që zbatohet

edukim mjedisor  
pasuri natyrore

aksion pastrami  
park kombëtar

## 5 qershor 2025, Dita Botërore e Shpendëve Shtegtarë

Specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një orë mjedisore në shkollën “Koço Shukallari”, me temë “Dita Botërore e Mjedisit”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit të nxënësit për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, si dhe pasojat që sjell veprimtaria njerëzore ndaj natyrës.



ndërgjegjësim

ditë botërore

mjedis i pastër





11 qershor 2025, orë mjesdise

Specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore me studentët e degës së Biokimisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë. Qëllimi i aktivitetit ishte njohja e studentëve me teknikat e avancuara për monitorimin e cilësisë së ujërave, përmes përdorimit të kite-ve dhe sondës parametrrike.